

VENDIM
Nr. 161, datë 3.2.2008

**PËR PËRCAKTIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT DHE TË TARIFËS SË
SHKOLLIMIT PËR STUDIMET SPECIALIZUESE AFATGJATA, PRANË
FAKULTETIT TË MJEKËSISË, TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS, PËR VITIN
AKADEMIK 2007-2008**

(Ndryshuar me VKM nr. 878, datë 18.6.2008)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 34 e 75 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. *Kuota e pranimi në programet e studimeve specializuese afatgjata, pranë Fakultetit të Mjekësisë, të Universitetit të Tiranës, për vitin akademik 2007-2008, të jetë 182, e ndarë në specialitete, sipas shtojcës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.*

2. Tarifa vjetore e shkollimit për studimet specializuese afatgjata, pranë Fakultetit të Mjekësisë, të Universitetit të Tiranës, të jetë 40 000 (dyzet mijë) lekë.

Studentët e shkëlqyer nuk e paguajnë tarifën e shkollimit në vitin akademik pasardhës.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Shtojcë Nr.1: *(Ndryshuar me VKM nr. 878, datë 18.6.2008)*

**KUOTA E PRANIMIT NË STUDIMET SPECIALIZUESE AFATGJATA, SIPAS
SPECIALITETEVE, PRANË FAKULTETIT TË MJEKËSISË TË UNIVERSITETIT TË
TIRANËS PËR VITIN AKADEMIK 2007-2008**

Nr.	Kursi i specializimit	Ministria e Shëndetësisë	Ministria e Mbrojtjes	Ministria e Drejtësisë	Kuota të lira	Shuma
1.	Alergologji	4	-	-	3	7
2.	Anatomi Patologjike	2	-	-	3	5
3.	Anestezi-Reanimacion	11	1	-	-	12
4.	Dermatologji	5	-	-	-	5
5.	Endokrinologji	6	-	-	-	6
6.	Gastroenterologji	5	-	-	-	5
7.	Hematologji	5	-	-	-	5
8.	Imazheri	4	1	-	-	5
9.	Kardiologji	7	-	-	-	7
10.	Kirurgji Maxilo-Faciale	-	1	-	4	5
11.	Kirurgji e Përgjithshme	7	1	-	-	8
12.	Lab.Klinik-Biokimik	6	-	-	-	6
13.	Mikrobiologji	4	1	-	-	5
14.	Mjek Familje	9	-	-	1	10
16.	Nefrologji	3	-	-	2	5
17.	Neurologji	5	-	-	-	5
18.	Obstetrikë-Gjinekologji	8	-	-	-	8
19.	Okulistikë	5	1	1	-	7
20.	Onkologji	3	-	-	2	5
21.	O.R.L.	7	-	-	-	7
22.	Ortopedi-Traumatologji	4	2	-	-	6
23.	Pediatri	10	-	-	-	10
24.	Psikiatri	5	-	-	-	5
25.	Reumatologji	7	-	-	-	7
26.	Sëmundje infektive	6	-	-	-	6
27.	Shëndet Publik	8	2	-	-	10
28.	Terapi Stomatologjike	-	-	-	5	5
30.	Toksikologji	-	-	-	5	5
	Gjithsej	146	10	1	25	182